



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 30

Tiranë – E martë, 12 mars 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 25, datë 28.2.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike..... 1341
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 26, datë 28.2.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë “OSHEE” sh.a. për fillimin e procedurës për një ndryshim në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016”, i ndryshuar..... 1342
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 27, datë 28.2.2019	Për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Thirrë” me fuqi të instaluar 1820 KW..... 1344
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 28, datë 28.2.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike..... 1345
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 29, datë 28.2.2019	Mbi mosfillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “HIDRO VIZION” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Razdoll”, me fuqi të instaluar 700 KW..... 1345
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 30, datë 28.2.2019	Mbi pranimin e kërkesës së shoqërisë “A.E. DISTRIBUTION” sh.p.k. për heqjen e licencës së veprimtarisë së furnizimit me energji elektrike..... 1346
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 31, datë 28.2.2019	Mbi pranimin e kërkesës së shoqërisë “A.E. DISTRIBUTION” sh.p.k. për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike..... 1347
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 32, datë 28.2.2019	Mbi miratimin e “Propozimit të të gjithë OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit në përputhje me nenin 75 të “Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485”, të datës 2 gusht 2017, që përcakton një

	udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”.....	1348
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 33, datë 28.2.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë “SIMA-COM” sh.p.k., për fillimin e procedurës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s me nr. 263, datë 19.12.2018, “Mbi miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2018”.....	1349
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 34, datë 28.2.2019	Mbi kërkesën e shoqërisë “AFRIMI K” sh.p.k., për fillimin e procedurës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, “Mbi miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2018”.....	1351
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 36, datë 4.3.2019	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, i ndryshuar, me vendimin nr. 261, datë 19.12.2018, “Për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”.....	1353
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 37, datë 4.3.2019	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, i ndryshuar, me vendimin nr. 262, datë 19.12.2018, “Për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”.....	1354
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 3369, datë 6.3.2019	Për hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje.....	1355
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 2747/1, datë 5.3.2019	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i segmentit rrugor Papër-Cërrik”.....	1355



VENDIM
Nr. 25, datë 28.2.2019

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“KESH” SHA NË AKTIVITETIN E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “ç”, dhe nenit 39, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, *“Për sektorin e energjisë elektrike”*, i ndryshuar, neni 4, pika 1, germa “d”; neni 5, pika 1, germa “d”, neni 13, të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 15 të *“Rregullores për Organizimit Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.2.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike,

Kostatoi se:

- Me Vendimin e Bordit nr. 4, datë 17.1.2019, ERE ka filluar procedurat për licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

- Me shkresat nr. 5/2 prot., datë 18.1.2019 dhe nr. 5/7 prot., datë 13.2.2019, ERE i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për informacion, lidhur me kërkesën e shoqërisë “KESH” sh.a. për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nisur nga parashikimi i pikës 3, germa “b”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 729, datë 8.12.2017.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE, me shkresën nr. 32/1 prot., datë 18.1.2019, publikoi në median e shkruar njoftimin për fillimin e kësaj procedure.

- Nuk rezulton të ketë ardhur asnjë koment nga palët.

- Nuk rezulton të ketë ardhur asnjë përgjigje nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me këtë kërkim.

ERE shqyrtoi aplikimin e shoqërisë KESH sh.a. dhe, nga sa depozituar në ERE me këtë kërkesë rezulton si më poshtë.

Aplikimi i shoqërisë “KESH” sh.a. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në *“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”* si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, germa “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7.1, germa “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “KESH” sh.a., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 (pesë) vjeçar, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi



VENDIM

Nr. 26, datë 28.2.2019

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“OSHEE” SHA PËR FILLIMIN E
PROCEDURËS PËR NJË NDRYSHIM NË
“RREGULLOREN PËR PROCEDURAT E
BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË
RRJETET E SHPËRNDARJES DHE TË
TRANSMETIMIT DHE PËR BLERJEN
DHE SHITJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR TË SIGURUAR
PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE TË
SHËRBIMIT PUBLIK” MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 103
DATË 23.6.2016”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 19, germa “P”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 244, “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” dhe “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 214, datë 28.12.2017, nenit 19, pika 1, germa “P” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 28.2.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përpiluar nga drejtoritë teknike mbi kërkesën e shoqërisë “OSHEE” sh.a. për një ndryshim në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”,

Konstatoi se:

- OSHEE sh.a. me shkresën nr. 1785/1 prot., datë 31.1.2019, i është drejtuar ERE-s me kërkesën për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, “Mbi miratimin e Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, i ndryshuar me vendimin nr. 168, datë 26.10.2017 të Bordit të ERE-s.

- Me anë të kësaj kërkesë shoqëria “OSHEE” sh.a. thekson se, duke marrë parasysh situatën mjaft delikate me të cilën po përballet, vlerësohet si e domosdoshme që ERE të marrë në konsideratë heqjen nga “Rregullorja për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, të termit kontraktual “Afati i pagesës së faturës”, duke lënë mundësinë që OSHEE-ja të përcaktojë termat e pagesës sipas sezonalitetit të aktivitetit të saj, i cili mund të jetë si 30 apo edhe 180 ditë, duke argumentuar se:

1. OSHEE-ja duke vlerësuar rrisqet dhe dëmet që do të shkakttoheshin nga kjo situatë pamundësie likuiditeti siç janë:

a) penalitetet që do të aplikoheshin nga shoqëritë tregtare të energjisë;

b) rrishtin e pamundësisë së blerjes së energjisë gjatë muajve shkurt, mars etj. 2019, si rezultat i debive të krijuara;

c) përkeqësimi i reputacionit të shoqërisë “OSHEE” sh.a. si pasojë e mos respektimit të kontratave ndaj shoqërive tregtare të energjisë. Kujtojmë që reputacioni i OSHEE-së është përmirësuar me shumë përpjekje gjatë 4 viteve të fundit dhe përkeqësimi i tij do të sillte menjëherë çmime me të larta energjie për periudhat në vijim.

2. OSHEE-ja vlerëson si të arsyeshme dhe shumë imediate marrjen në konsideratë të ndryshimit të afatit të pagesës së faturave deri në 180 ditë.

3. Pagesat me terma disamujore të faturave aplikohen gjerë në treg dhe nuk është një koncept që OSHEE-ja po e fut për herë të parë.

- Pas shqyrtimit të argumenteve sa më sipër, ERE konkludon se:

“Rregullorja për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 168, datë 26.10.2017, në nenin 20, germa “a”, përcakton se: “i gjithë procesi i rakordimit të sasive të energjisë elektrike të lëvruar mes palëve, vlerave përkatëse financiare, si dhe faturimi, duhet të mbyllet brenda 10 ditëve kalendarike nga data e fundit e



lëvrimit të energjisë elektrike. Pagesa do të bëhet nga blerësi brenda 90 ditëve nga dita e fundit e lëvrimit.”

- OSHEE sh.a. në të sajën sipërcituar nuk ka shpjeguar se cilat janë rrethanat e reja me të cilat u njoh pas kësaj vendimmarrjeje. Penalitetet që do të aplikoheshin për OSHEE apo përkeqësimi i reputacionit të shoqërisë, si pasojë e mosrespektimit të kontratave ndaj shoqërive tregtare të energjisë nuk janë prova që të mund ta çojnë Bordin e ERE-s në marrjen e një vendimi të ndryshëm.

- Ndryshimi i termave të pagesës sipas situatës financiare të OSHEE-së, duket se është në favor të interesave të saj, por rëndon mbi interesat e tregut të energjisë, të tregtarëve të vegjël, të cilët këtë kosto financiare do ta përfshijnë në çmimin e shitjes së energjisë elektrike, duke rritur dhe kostot për klientët fundorë.

- Gjatë fazës së draftimit dhe diskutimit me palët e interesit të kësaj rregulloreje, nga më shumë se një palë është propozuar që kontratat duhet të hartohen në përputhje me dispozitat e “Marrëveshjes së lidhur për lëvrimin dhe pranimin e energjisë elektrike”, të hartuar nga “Federata Europiane e Tregtarëve të Energjisë”. Ky parashikim nuk është marrë në konsideratë në atë kohë për t’u vendosur si një kusht detyrues për palët, duke qenë se Shqipëria nuk është palë në këtë marrëveshje e për më tepër ky afat prej 20 ditësh pas lëvrimit të energjisë u dakordësua nga palët, si kufizues në kushtet e një tregu në rimëkëmbje.

- Në asnjë treg të lirë të shitjes së energjisë elektrike, në rajon apo dhe më gjerë, nuk ekzistojnë praktika të tilla për termat e pagesës së energjisë elektrike, si ato që propozon OSHEE sh.a.

- OSHEE sh.a. nuk ka paraqitur një analizë të kostove, si dhe prova bindëse për të argumentuar që çmimi i blerjes së energjisë elektrike, për shkak të ndryshimit të afatit të pagesave, nuk ka pësuar ndryshime.

- Kontrata që vetë OSHEE-ja ka për shitjen e energjisë elektrike te klientët fundorë, ka parashikuar terma pagese 30 ditë pas ditës së lëvrimit, afat pas të cilit klientët janë të detyruar të paguajnë penalitete.

- Në nenin 6, të ligjit nr. 48/2014, “Për sektorin e energjisë elektrike”, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, parashikohet se: “Afatet kontraktore për kryerjen e pagesave nuk mund të jenë më të gjata se 60 ditë nga data e parashikuar në shkronjën

“a” të këtij neni. Në ato raste kur me kontratë apo në marrëveshje me palët është caktuar një afat tjetër, ky afat konsiderohet i vlefshëm, me përjashtim të rasteve kur dëmton dhe vë në pozitë diskriminuase kreditorin”.

- Në miratimin e “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, ERE është konsultuar me KESH sh.a., OST sh.a., shoqatat FIAA dhe AEES, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, si dhe Autoritetin e Konkurrencës dhe, me sa rezulton deri më sot nga ana e OSHEE-së një fakt i tillë nuk është marrë parasysh në përcjelljen e kërkesës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Nuk janë siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga vendimi i Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, “Rregullore për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, i ndryshuar.

2. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “OSHEE” sh.a., për fillimin e procedurës për një ndryshim në nenin 20, germa “a”, të “Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.103, datë 23.6.2016.

3. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OSHEE sh.a. dhe palët e interesit mbi këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi



VENDIM

Nr. 27, datë 28.2.2019

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “SANG 1”
SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“THIRRË” ME FUQI TË INSTALUAR
1820 KW**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2 germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 10 pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.2.2019, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “SANG 1” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurave për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie.

Konstatoi se:

Shoqëria “SANG 1” sh.p.k., me shkresën nr. 124 prot., datë 6.2.2019, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Thirrë” me fuqi të instaluar 1820 KW.

Aplikimi i shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., i plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “f”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3 gjerat “a” dhe “d”; pika 4.1.4,

gjerat “b” dhe “c”, “d”, “e”; pika 4.1.5 germa “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Kohëzgjatja e kontratës nr. 2753 Rep; nr. 1403/2 Kol, datë 12.12.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Thirrë” me kapacitet prodhues 1820 MW, në përroin e Thirrës dhe në degët formuese të tij, ai i Kumbllës, Runjës dhe Qarrit, degë e lumit Fani i Vogël, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë”, do të jetë 49 vjet nga data e hyrjes në fuqi të saj me të drejtë ripërsëritje.

Neni 38, i ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, përcakton se: ERE përcakton kushtet që duhet të përmbushen për marrjen e çdo licence, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera: a) afatin e vlefshmërisë së licencës, i cili për veprimtaritë e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet;

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit të aplikuesit që ka të bëjë me:

- nenin 9, pika 4.1.3, germa “b”, “c”; nenin 9, pika 4.1.4, germa “a” (Studimi i fizibilitetit) dhe nenin 9, pika 4.1.5, gjerat “a” dhe “b” (Miratimi i pikës së lidhjes) dhe (Leja e përdorimit të ujit), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Thirrë” me fuqi të instaluar 1820 KW për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi

**VENDIM****Nr. 28, datë 28.2.2019**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “SANG 1”
SHPK, NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, *“Për sektorin e energjisë elektrike”*, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 10, pika 1 dhe nenit 3 të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19 pika 1 germa “a” të *“Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.2.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për licencimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “SANG 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 124 prot., datë 6.2.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “SANG 1” sh.p.k. i plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në *“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germa “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa “b” dhe “c” (Bilanci financiar i tre viteve të fundit) dhe (Dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit): dokumentacioni teknik për veprimtarinë tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, gjerat “a”, “d” dhe “b” (Sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në GWh / sipas viteve), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë e procedurën për licencimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi

VENDIM**Nr. 29, datë 28.2.2019**

**MBI MOSFILLIMIN E PROCEDURËS
PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“HIDRO VIZION” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“RAZDOLL”, ME FUQI TË
INSTALUAR 700 KW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 6, germa “b”, të ligjit nr. 43/2015, *“Për sektorin e energjisë elektrike”*, i ndryshuar, nenit 4, pika 2, germa “a” dhe nenit 10, pika 3, të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, nenit 19, pika 1, germa “a”, të



“Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, vendim të Bordit të ERE-s nr. 153, datë 11.12.2015, *“Mbi operimin në treg të prodhuesve me kapacitet të instaluar nën 1 MW dhe vetëprodhuesve të energjisë elektrike”*, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.2.2019 pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hidro Vizion” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hidro Vizion” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Razdoll” me fuqi të instaluar 700 KW, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Hidro Vizion” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 131 prot., datë 7.2.2019, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Razdoll”, me kapacitet të instaluar 700 KW.

- Nga aplikimi i vihet re se HEC “Razdoll”, për të cilin kërkon të licencohet subjekti “Hidro Vizion” sh.p.k., ka një kapacitet të instaluar 700 kW, pra, më të vogël se 1 MW.

- Ligji nr. 43/2015, *“Për sektorin e energjisë elektrike”*, i ndryshuar, në nenin 37, pika 6, germa “b”, parashikon: *“Nuk janë të detyruar të pajisen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike: ...b) prodhuesit, përfshirë edhe vetëprodhuesit e lidhur me rrjetin kombëtar, me kapacitet të instaluar deri në 1 MW”*.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 153, datë 11.12.2015, *“Mbi operimin në treg të prodhuesve me kapacitet të instaluar nën 1 MW dhe vetëprodhuesve të energjisë elektrike”* ka vendosur:

1. *Vetëprodhuesit, të cilët nuk janë të lidhur me rrjetin kombëtar ose kur lidhen në rrjetin kombëtar për qëllime të mirëmbajtjes së njësisë së prodhimit, nuk pajisen me licencë nga ERE.*

2. *Prodhuesit, përfshirë dhe vetëprodhuesit e energjisë elektrike të lidhur në rrjetin kombëtar, me kapacitet të instaluar deri në 1 MW, nuk pajisen me licencë nga ERE.*

3. *Kategoritë e prodhuesve dhe të vetëprodhuesve të parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi kanë detyrimin të njoftojnë ERE-n, në çdo rast që fillojnë të ushtrojnë veprimtari në tregun e energjisë elektrike.*

- Aplikuesi pas paraqitjes në OSHEE të dokumentacionit të nevojshëm, teknik, administrativ dhe ligjor, nuk ka asnjë pengesë për të nënshkruar kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike me të ngarkuarin me detyrimin e shërbimit publik, sipas VKM, nr. 244, datë 30.3.2016, *“Mbi kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”*.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Hidro Vizion” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Razdoll”, me fuqi të instaluar 700 KW.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi

VENDIM Nr. 30, datë 28.2.2019

MBI PRANIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “A. E. DISTRIBUTION” SHPK PËR HEQJEN E LICENCËS SË VEPRIMTARISË SË FURNIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, *“Për sektorin e energjisë elektrike”*, i ndryshuar, nenit 5 germa “dh”; nenit 7, paragrafi 2, dhe nenit 9 të *“Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe nenit 15, të *“Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij



të datës 28.2.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi kërkesën e shoqërisë “A. E. DISTRIBUTION” sh.p.k., për heqjen e licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- ERE, me vendimin e Bordit nr. 83, datë 9.6.2016, ka licencuar shoqërinë “A. E. DISTRIBUTION” sh.p.k. në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “A. E. DISTRIBUTION” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE nr. 157 prot, datë 14.2.2019, ka kërkuar me vullnetin e saj të plotë, heqjen e licencës së veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.

- Kërkesa e shoqërisë “A. E. DISTRIBUTION” sh.p.k. për heqjen e licencës së furnizimit të energjisë elektrike, vjen në zbatim të nenit 42, pika 1, germa “dh”, “Heqja e një licence”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe nenit 5, germa “dh” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Subjekti ka përmbushur të gjitha detyrimet që lidhen me pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “A. E. DISTRIBUTION” sh.p.k., për heqjen e licencës së veprimtarisë së furnizimit me energji elektrike me nr. 345, seria F16, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 9.6.2016.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, licenca e sipërcituar humbet fuqinë e saj juridike.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë kërkuuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi

VENDIM

Nr. 31, datë 28.2.2019

MBI PRANIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “A.E. DISTRIBUTION” SHPK PËR HEQJEN E LICENCËS SË VEPRIMTARISË SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 42, pika 1, germa “dh”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 5 germa “dh”; nenit 7, paragrafi 2, dhe nenit 9, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 58, datë 18.4.2017, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordin i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.2.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi kërkesën e shoqërisë “A. E. DISTRIBUTION” sh.p.k., për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordin i Komisionerëve të ERE-s me vendimin nr. 82, datë 9.6.2016, ka licencuar shoqërinë “A. E. DISTRIBUTION” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria “A. E. DISTRIBUTION” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 157 prot, datë 14.2.2019, ka kërkuar me vullnetin e saj të plotë, heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

- Kërkesa e shoqërisë “A. E. DISTRIBUTION” sh.p.k. për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, vjen në zbatim të nenit 42, pika 1, germa “dh”, “Heqja e një licence”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe nenit 5, germa “dh” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.4.2017.

- Subjekti i ka përmbushur të gjitha detyrimet që lidhen me pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordin i ERE-s,



VENDOSI:

1. Të pranojë kërkesën e shoqërisë “A. E. DISTRIBUTION” sh.p.k., për heqjen e licencës së veprimtarisë së tregtimit me energji elektrike me nr. 344, seria T16, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 82, datë 9.6.2016.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi licenca e sipërcituar humbet fuqinë e saj juridike.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë kërkesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi

VENDIM
Nr. 32, datë 28.2.2019

**MBI MIRATIMIN E “PROPOZIMIT TË
TË GJITHË OST-VE PËR NJË
METODOLOGJI PËR KOORDINIMIN E
ANALIZAVE TË SIGURISË SË
OPERIMIT NË PËRPTHJE ME NENIN
75 TË RREGULLORES SË KOMISIONIT
TË BASHKIMIT EVROPIAN (BE)
2017/1485, TË DATËS 2 GUSHT 2017, QË
PËRCAKTON NJË UDHËZUES MBI
OPERIMIN E SISTEMIT TË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 7, nenit 16, nenit 53 dhe nenit 63, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, nenit 75 të “Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485”, të datës 2 gusht 2017, të nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 28.2.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, për miratimin e propozimit të të gjitha OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit në

përputhje me nenin 75, të “Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485”, të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “OST” sh.a., me shkresën nr. 7997 prot., datë 20.11.2018, ka përcjellë në ERE për miratim “Propozimet e të gjithë OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit në përputhje me nenin 75, të “Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485” të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”.

- ERE, me vendimin e Bordit nr. 253, datë 11.12.2018, filloi procedurën për miratimin e “Propozimeve të të gjithë OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit në përputhje me nenin 75, të “Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485” të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”.

- ERE, në vijim të kësaj vendimmarrje dhe në zbatim të nenit 26, pikat 3 dhe 5, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, me shkresën nr. 30/2 prot., datë 6.2.2019, publikoi në median e shkruar njoftimin për fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën nr. 35/2 prot., datë 28.1.2019, ka njoftuar këtë vendim pranë palëve të interesit, nga ku rezultoi që nuk kishte ndonjë koment apo opinion nga palët e interesuara.

- Kjo vendimmarrje është në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, përkatësisht nenit 56 dhe nenit 63, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në “Kodin e Transmetimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, përkatësisht neni 68 të “Metodologjisë për Koordinimin e Analizave të Sigurisë”.

- Propozimet e të gjithë OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit, janë në përputhje me nenin 75 të “Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485”, të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit



të transmetimit të energjisë elektrike”, si dhe dokumentin mbështetës mbi mënyrën e zbatimit të këtij propozimi, të përkthyer në shqip nga “OST” sh.a.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë “Propozimet e të gjithë OST-ve për një metodologji për koordinimin e analizave të sigurisë së operimit në përputhje me nenin 75 të “Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485”, të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike”.

2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie nga palët në interpretim të versionit shqip.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi

VENDIM Nr. 33, datë 28.2.2019

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “SIMA-COM” SHPK, PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 263, DATË 19.12.2018, “MBI MIRATIMIN E PAGESAVE RREGULLATORE PËR VITIN 2018

Në mbështetje të nenit 16, nenit 17, pika 4 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 7 të “Rregullores për përcaktimin e pagesave rregullatore”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, pikës 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, “Mbi miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2018”, nenit 16, pika 1, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96,

17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 28.2.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve mbi rishikimin e pagesës rregullatore për vitin 2018 të të licencuarit “SIMA-COM” sh.p.k.,

Konstatoi se:

- Shoqëria “SIMA-COM” sh.p.k., me anë të shkresës nr. 43, datë 31.1.2018, ka kërkuar rishikimin e pagesës rregullatore për vitin 2018, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018. Me anë të kësaj shkrese kjo shoqëri sqaron se ndërtimi i veprës nuk ka përfunduar ende dhe, për rrjedhojë, nuk ka ushtruar aktivitetin e licencuar.

- Kërkesa për rishikimin e pagesës rregullatore për vitin 2018 për këtë shoqëri vjen me argumentin se vlera e përcaktuar nga ERE në lidhje me këtë pagesë është e lartë në kohën kur kjo shoqëri nuk ka ushtruar aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, për të cilën është licencuar.

- Shoqëria “SIMA-COM” sh.p.k. bëri me dije se ushtron aktivitet tjetër dhe të ardhurat e deklaruar në pasqyrën e performancës (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve) të pasqyrave financiare të dërguara në ERE, vijnë nga aktivitet tjetër, të palicencuar nga ERE.

- ERE, me anë të shkresës nr. 345-38, datë 27.4.2018, në kuadër të procesit për përcaktimin e pagesave rregullatore, ka kërkuar prej shoqërisë “SIMA-COM” sh.p.k. dorëzimin e pasqyrave financiare të plota, në zbatim të nenit 46, të ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, pasi ishin tejkaluar afatet e dorëzimit të tyre.

- Shoqëria “SIMA-COM” sh.p.k. u përgjigj nëpërmjet shkresës nr. 17, datë 7.5.2018, ku paraqiti në ERE pasqyrat financiare të paaudituar.

- Në vijimësi, ERE, me shkresën nr. 552/119, datë 15.8.2018, i kërkoj shoqërisë “SIMA-COM” sh.p.k., dërgimin e pasqyrave financiare të audituara konform legjislacionit në fuqi, kërkesë të cilës shoqëria nuk iu përgjigj.

- ERE në datë 9.11.2018 zhvilloi seancën dëgjimore me tre grupe të licencuarish, ku u diskutuan në lidhje me raportimin vjetor të pasqyrave financiare për aktivitetin e ushtruar gjatë vitit 2017, si dhe paqartësinë e shënimeve shpjeguese lidhur me ndarjen e llogarive sipas aktiviteteve, çështje të cilat ishin bërë pengesë për llogaritjeve e pagesave rregullatore. Në përfundim



iu komunikua shoqërive të licencuara që informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare duhet të përmbante të dhëna analitike, në lidhje me të ardhurat e realizuara sipas aktiviteteve të licencuara, si dhe të ishte konform përcaktimeve ligjore lidhur me raportimin tekniko-ekonomik dhe financiar në ERE, në të kundërt ERE do të përdorte për llogaritjen e pagesave rregullatore të ardhurat në total, sikurse deklaruar nga shoqëritë e licencuara.

- ERE, në përlllogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2018, zbatoi *“Rregulloren mbi përcaktimin e miratimit të pagesave rregullatore”* të miratuar me vendimin nr. 190, datë 23.11.2017, të Bordit të ERE-s, e cila është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 43/2015, *“Për sektorin e energjisë elektrike”* i ndryshuar.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, u miratuan pagesat rregullatore për vitin 2018 si më poshtë, ku ndër të tjera për subjektin kërkues, ka parashikuar:

“SIMA-COM” sh.p.k. në vlerën 191,140 lekë.

- ERE me shkresat nr. 55/120, datë 15.1.2019 (marrë në dorëzim nga subjekti sipas verifikimit nga Posta Shqiptare në datën 23.1.2019), bëri njoftimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, *“Mbi miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2018”*.

- Shoqëria “SIMA-COM” sh.p.k., me anë të shkresës nr. 43, datë 31.1.2019 ka depozituar në ERE kërkesën për rishikimin e një vendimi, jashtë afateve ligjore sipas përcaktimeve të nenit 16, pika 1, të *“Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016 dhe nuk legjitimohet në kërkesën për rishikimin e vendimit nr. 263, datë 19.12.2018 të Bordit të ERE-s.

- ERE, në çdo rast që evidenton pasaktësi në llogaritjen e pagesave të rregullimit për të licencuarit, edhe me iniciativën e saj mund të marrë masa për korrigjimin e pagesave rregullatore në të ardhmen.

- Neni 6, pika 4, e *“Rregullores mbi përcaktimin e pagesave rregullatore”*, parashikon që: *“Në rastet kur një shoqëri e licencuar nuk ka paraqitur pasqyrat financiare, siç parashikon neni 46 i ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, atëherë ERE do ta përlllogaritë këtë pagesë mbi bazën e vlerësimeve nga të dhëna të marra nga Publikime Zyrtare”*.

- Në mirëkuptim të rrethanave të faktit, deklarimeve të depozituara me vonesë, në kërkesat për rishikimin e vendimit për përcaktimin e pagesave rregullatore, në pikën 2 të vendimit të Bordit ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, *“Mbi miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2018”*, në dispozitiv të kësaj vendimmarrjeje, është përcaktuar se:

“Diferencat që rezultojnë nga pasqyrat financiare të certifikuara për vitin 2017, të konsiderohen në llogaritjen e pagesave të rregullimit të periudhës pasardhëse”.

- Kërkesa e shoqërisë “SIMA-COM” sh.p.k. e cila është jashtë afateve ligjore për të vënë në lëvizje Bordin e ERE-s, me qëllim marrjen e një vendimi të ndryshëm nga ai i marrë për përcaktimin e pagesave rregullatore, i është dhënë përgjigje me sa sanksionuar në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, *“Mbi miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2018”*.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “SIMA-COM” sh.p.k., për fillimin e procedurës për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, *“Mbi miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2018”*.

2. Njoftimin shoqërisë “SIMA-COM” sh.p.k., se korrigjimi i pagesave të rregullimit për shoqërinë e licencuar nga ERE, për diferencat që rezultojnë ndërmjet Pagesës Rregullatore të miratuar për vitin 2018 dhe asaj të rishikuar, do të konsiderohet në llogaritjen e pagesave rregullatore për periudhat pasardhëse, në zbatim të pikës 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, *“Mbi miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2018”*.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë shoqërinë “SIMA-COM” sh.p.k. mbi këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi



VENDIM

Nr. 34, datë 28.2.2019

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“AFRIMI K” SHPK, PËR FILLIMIN E
PROCEDURËS PËR RISHIKIMIN E
VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S
NR. 263, DATË 19.12.2018, “MBI
MIRATIMIN E PAGESAVE
RREGULLATORE PËR VITIN 2018”**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 17, pika 4 të ligjit nr. 43/2015, *“Për sektorin e energjisë elektrike”*, i ndryshuar; nenit 7 të *“Rregullores për përcaktimin e pagesave rregullatore”*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 23.11.2017, pikës 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, *“Mbi miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2018”*, të nenit 16, pika 1, të *“Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 28.2.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përpiluar nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve mbi rishikimin e pagesës rregullatore për vitin 2018 të të licencuarit “AFRIMI K” sh.p.k.,

Konstatoi se:

- Shoqëria “AFRIMI K” sh.p.k. me anë të shkresës nr. 73, datë 5.2.2019, ka kërkuar rishikimin e pagesës rregullatore për vitin 2018 miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, me argumentimin se vepra nuk ka filluar ende ndërtimin dhe për rrjedhojë nuk është në proces prodhimi të energjisë elektrike.

- Kërkesa për rishikimin e pagesës rregullatore për vitin 2018, për këtë shoqëri vjen me argumentin se vlera e përcaktuar nga ERE në lidhje me këtë pagesë, është e lartë në kohën kur kjo shoqëri nuk ka ushtruar aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, për të cilën është licencuar.

- Shoqëria “AFRIMI-K” sh.p.k. bën me dije se ushtron aktivitet tjetër dhe të ardhurat e deklaruara në pasqyrën e performancës (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve) të pasqyrave financiare të dërguara në ERE, vijnë nga aktivitet tjetër, të palicencuar nga ERE.

- ERE, me anë të shkresës nr. 345/1, datë 27.4.2018, në kuadër të procesit për përcaktimin e pagesave rregullatore, ka kërkuar prej shoqërisë “AFRIMI K” sh.p.k., dorëzimin e pasqyrave

financiare të plota, në zbatim të nenit 46, të ligjit 43/2015, *“Për sektorin e energjisë elektrike”*, i ndryshuar, pasi ishin tejkaluar afatet e dorëzimit të tyre.

- Shoqëria “AFRIMI K” sh.p.k. iu përgjigj nëpërmjet shkresës nr. 36, datë 9.5.2018, ku paraqiti në ERE pasqyrat financiare të paaudituar.

- Në vijimësi, ERE me shkresën nr. 552/57, datë 15.8.2018, i kërkoj shoqërisë “AFRIMI K” sh.p.k., dërgimin e pasqyrave financiare të audituara konform legjislacionit në fuqi, kërkesë së cilës kjo shoqëri nuk iu përgjigj.

- ERE në datë 9.11.2018 zhvilloi seanca dëgjimore me tre grupe të licencuarish, ku u diskutuan në lidhje me raportimin vjetor të pasqyrave financiare për aktivitetin e ushtruar gjatë vitit 2017, si dhe paqartësinë e shënimeve shpjeguese lidhur me ndarjen e llogarive sipas aktiviteteve, çështje të cilat ishin bërë pengesë për llogaritjeve e pagesave rregullatore. Në përfundim iu komunikua shoqërive të licencuara që, informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare duhet të përmbante të dhëna analitike, në lidhje me të ardhurat e realizuara sipas aktiviteteve të licensuara, si dhe të ishte konform përcaktimeve ligjore lidhur me raportimin tekniko-ekonomik dhe financiar në ERE, në të kundërt ERE do të përdorte për llogaritjen e pagesave rregullatore të ardhurat në total sikurse deklaruar nga shoqëritë e licensuara.

- ERE, në përlogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2018, zbatoi *“Rregulloren mbi përcaktimin e miratimin e pagesave rregullatore”* të miratuar me vendimin nr. 190, datë 23.11.2017, të Bordit të ERE-s, e cila është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 43/2015, *“Për sektorin e energjisë elektrike”* i ndryshuar.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, u miratuan pagesat rregullatore për vitin 2018, ndër të tjera për shoqërinë “AFRIMI K” sh.p.k. si më poshtë:

“AFRIMI K” sh.p.k. në vlerën 185,824 lekë

- ERE, me shkresën nr. 55/119, datë 15.1.2019 (marrë në dorëzim nga subjekti sipas verifikimit nga Posta Shqiptare në datën 23.1.2019), bëri njoftimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, *“Mbi miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2018”*.



- Shoqëria “AFRIMI K” sh.p.k. ka depozituar në ERE kërkesën për rishikimin e një vendimi, jashtë afateve ligjore sipas përcaktimeve të nenit 16, pika 1, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016 të Bordit të ERE-s dhe nuk legjitimohet në kërkesën për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, “Mbi miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2018”.

- ERE, në çdo rast që evidenton pasaktësi në llogaritjen e pagesave të rregullimit për të licencuarit, edhe me iniciativën e saj mund të marrë masa për korrigjimin e pagesave rregullatore në të ardhmen.

- Neni 6, pika 4, e “Rregullores mbi përcaktimin e pagesave rregullatore”, parashikon që: “Në rastet kur një shoqëri e licencuar nuk ka paraqitur pasqyrat financiare, siç parashikon neni 46, i ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, atëherë ERE do ta përllogaritë këtë pagesë mbi bazën e vlerësimeve nga të dhëna të marra nga Publikime Zyrtare”.

- ERE u ndodh në kushtet e depozitimit të pasqyrave financiare me të meta, në shkelje të parashikimeve të ligjit, i cili orienton për paraqitje të pasqyrave financiare të ndara për aktivitetet që ushtron i licencuari.

- Pavarësisht moskorrektesës nga ana e shoqërive të licencuara në lidhje me detyrimin për raportim konform legjislacionit në fuqi, gjatë procesit të llogaritjes së pagesave rregullatore, mendojmë se një tarifë më e lartë nga ajo prej 40,000 lekësh, sipas përcaktimit të nenit 6, pika 6.3, të “Rregullores për përcaktimin e pagesave rregullatore”, e rëndon buxhetin e tyre, në kushtet kur nuk kanë ushtruar aktivitetin e licencuar.

- Në mirëkuptim të rrethanave të faktit, deklarimeve të depozituara me vonesë, në kërkesat për rishikimin e vendimit për përcaktimin e pagesave rregullatore, sjellim në vëmendje se në pikën 2 të vendimit të Bordit ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, “Mbi miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2018”, në dispozitiv të kësaj vendimmarrjeje, bazuar në nenin 7 të “Rregullores për përcaktimin e pagesave rregullatore”, ka përcaktuar se:

“Diferencat që rezultojnë nga pasqyrat financiare të certifikuara për vitin 2017, të konsiderohen në llogaritjen e pagesave të rregullimit të periudhës pasardhëse”.

- Kërkesa e shoqërisë “AFRIMI K” sh.p.k., e cila është jashtë afateve ligjore për të vënë në lëvizje Bordin e ERE-s, me qëllim marrjen e një vendimi të ndryshëm nga ai i marrë për përcaktimin e pagesave rregullatore, i është dhënë përgjigje me sa sanksionuar në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, “Mbi miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2018”.

Për gjithë s më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “AFRIMI K” sh.p.k., për fillimin e procedurës për rishikimin e Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, “Mbi miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2018”.

2. Njoftimin shoqërisë “AFRIMI K” sh.p.k., se korrigjimi i pagesave të rregullimit për shoqërinë e licencuar nga ERE, për diferencat që rezultojnë ndërmjet pagesës rregullatore të miratuar për vitin 2018 dhe asaj të rishikuar, do të konsiderohet në llogaritjen e pagesave rregullatore për periudhat pasardhëse, në zbatim të pikës 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 263, datë 19.12.2018, “Mbi miratimin e pagesave rregullatore për vitin 2018”.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë shoqërinë “AFRIMI K” sh.p.k. mbi këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi



VENDIM

Nr. 36, datë 4.3.2019

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-S NR. 187, DATË
10.11.2017, I NDRYSHUAR, ME VENDIMIN
ME NR. 261, DATË 19.12.2018, “PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBGAZ”
SHA NË AKTIVITETIN E
SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 50; nenit 22, pika 2, gjerat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; VKM-së nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe për caktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të Aksioneve të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. dhe “Albgaz” sh.a.”, nenit 4, pika 1, gjerat “a” dhe “b”; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.3.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror” të ndryshuar,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE me vendimin nr. 187, datë 10.11.2017, ka vendosur “Për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror”, të ndryshuar me vendimin nr. 261, datë 19.12.2018.

- ERE, me shkresën nr. 188 prot., datë 26.2.2019, ka risjellë në vëmendje të “Albgaz” sh.a. se afati i shtyrjes së plotësimit të dokumentacionit të munguar përfundon në datën 4.3.2019 dhe se mosplotësimi i tij përbën shkak për rishikimin e vendimit nga ana e Bordit të ERE-s.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. i është drejtuar ERE-s me shkresën nr. 22 prot., datë 27.2.2019 (protokolluar në ERE me nr. 196, datë 28.2.2019), me anë të së cilës ka kërkuar shtyrjen e afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar deri në datën 20.12.2019, duke informuar se, “Albgaz” sh.a. ka bërë kërkesë në ZVRPP-në përkatëse, në kuadër të mundësisë të ecjes me ritme më të shpejta në procesin e regjistrimit të aseteve.

- Me qëllim plotësimin e dokumentacionit shoqëria “Albgaz” sh.a., informon ERE-n se ka aplikuar për transferimin e lejes mjedisore të (Tipi A) pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe është ende në pritje.

- Dokumentacioni i munguar për t’u plotësuar në vijim deri në datën 20.12.2019, nga ana e shoqërisë “Albgaz” sh.a. është si më poshtë:

- Pajisja me certifikatë pronësie për:

- Cërrik, Elbasan, me nr. pasurie 12/289;

- Drenovë, Mallakastër, me nr. pasurie 1/6;

- Balldren, Mallakastër.

- Pajisja me lejet dhe autorizimet mjedisore;

- Depozitimi në ERE i një certifikate sigurimi të lëshuar nga shoqëri sigurimi në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 mln USD.

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe për caktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. dhe “Albgaz” sh.a.”, është vendosur për shpëputjen e njësisë së gazit nga shoqëria “Albpetrol” sh.a. dhe krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., me kapital 100 % shtetëror. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 848 datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe për caktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive “Albpetrol” sh.a. dhe “Albgaz” sh.a.” rezulton se, “Albgaz” sh.a. ka në pronësi të gjitha tubacionet dhe asetet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë një ndryshim në paragrafin e parë të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, të ndryshuar, si më poshtë:

- “Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.12.2019, në mbështetje të nenit 24, pika 2 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë gjithë dokumentacionin e munguar, që ka të bëjë me:

- dokumentacionin që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka, për të kryer funksionet ose për të plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar.

- lejet dhe autorizimet mjedisore;

- një certifikate sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri) që evidenton



mbulimin e përgjegjësisë për dëmtimet për plagosje, sëmundje ose raste të vdekjes së personave ose për humbjen ose shkatërrimin e pronës të shkaktuar ose që kanë rezultuar prej aktiviteteve të aplikantit në kuadër të licensës së kërkuar në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 milionë USD.”

2. “Albgaz” sh.a. të paraqesë në ERE brenda datës 28.3.2019, praktikat dokumentare në lidhje me ecurinë e aplikimeve pranë institucioneve përkatëse, për pajisjen me lejet mjedisore dhe certifikatat e pronësisë.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi

VENDIM

Nr. 37, datë 4.3.2019

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 188, DATË 10.11.2017, I NDRYSHUAR, ME VENDIMIN NR. 262, DATË 19.12.2018, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBGAZ” SHA NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 50; nenit 22, pika 2, gjerat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”; nenit 113, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe për caktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërisë “Albpetrol” sh.a dhe “Albgaz” sh.a.”, nenit 4, pika 1, gjerat “a” dhe “b”; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.3.2019, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike për një ndryshim në

vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, të ndryshuar,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 188, datë 10.11.2017, ka vendosur “Për licencimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. në veprimtarinë e shpërndarjes së gazit natyror”, të ndryshuar me vendimin nr. 262, datë 19.12.2018.

- ERE, me shkresën nr. 188 prot., datë 26.2.2019, ka risjellë në vëmendje të “Albgaz” sh.a. se, afati i shtyrjes së plotësimit të dokumentacionit të munguar përfundon në datën 4.3.2019 dhe se mosplotësimi i tij përbën shkak për rishikimin e vendimit nga ana e Bordit të ERE-s.

- Shoqëria “Albgaz” sh.a. i është drejtuar ERE-s me shkresën nr. 22 prot., datë 27.2.2019 (protokolluar në ERE me nr. 196, datë 28.2.2019), me anë të së cilës ka kërkuar shtyrjen e afatit të dërgimit të dokumentacionit të munguar **deri në datën 20.12.2019**, duke informuar se “Albgaz” sh.a. ka bërë kërkesë në ZVRPP-në përkatëse, në kuadër të mundësimit të ecjes me ritme më të shpejta në procesin e regjistrimit të aseteve.

- Me qëllim plotësimin e dokumentacionit shoqëria “Albgaz” sh.a. informon ERE-n se ka aplikuar për transferimin e lejes mjedisore të (Tipi A) pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe është ende në pritje.

- Dokumentacioni i munguar për t’u plotësuar në vijim **deri në datën 20.12.2019**, nga ana e shoqërisë “Albgaz” sh.a. është si më poshtë:

- Pajisja me certifikatë pronësie për:

- Cërrik, Elbasan, me nr. pasurie 12/289;

- Drenovë, Mallakastër, me nr. pasurie 1/6;

- Balldren, Mallakastër.

- Pajisja me lejet dhe autorizimet mjedisore;

- Depozitimi në ERE i një certifikate sigurimi të lëshuar nga shoqëri sigurimi në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 mln USD.

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe për caktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. dhe “Albgaz” sh.a.” është vendosur për shkëputjen e njësisë së gazit nga shoqëria “Albpetrol” sh.a. dhe krijimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., me kapital 100 % shtetëror. Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 7.12.2016, “Për krijimin e



shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive “Albpetrol” sh.a. dhe “Albgaz” sh.a.” rezultoi se “Albgaz” sh.a. ka në pronësi të gjitha tubacionet dhe asetet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë një ndryshim në paragrafin e parë të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror”, të ndryshuar, si më poshtë:

- “Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30 vjeçar, me kushtin që brenda datës 20.12.2019, në mbështetje të nenit 24, pika 2 e Ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të plotësojë gjithë dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

- dokumentacionin që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka, për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar;

- lejet dhe autorizimet mjedisore;

- një certifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri) që evidenton mbulimin e përgjegjësisë për dëmtimet për plagosje, sëmundje ose raste të vdekjes së personave ose për humbjen ose shkatërrimin e pronës të shkaktuar ose që kanë rezultuar prej aktiviteteve të aplikantit në kuadër të licencës së kërkuar në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 milionë USD”.

2. “Albgaz” sh.a. të paraqesë në ERE brenda datës 28.3.2019, praktikat dokumentare në lidhje me aplikimet pranë institucioneve përkatëse, për pajisjen me lejet mjedisore dhe certifikatat e pronësisë.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi

NJOFTIM

Nr. 3369, datë 6.3.2019

PËR HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE

Në vijim të përmbushjes së procedurave të brendshme ligjore nga pala shqiptare për hyrjen në fuqi të “Marrëveshjes statusore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian mbi veprimet e ndërmarra nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë”, mbështetur në përcaktimin e nenit 12 të marrëveshjes, data e hyrjes në fuqi të saj është 1.5.2019.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Gazmend Barbullushi

KËRKESË

Nr. 2747/1, datë 5.3.2019

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Ndërtimi i segmentit rrugor Papër-Cërrik”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të VKM-së nr. 89, datë 3.6.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasuritë e llojit “tokë arë”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është **1,633,520.4 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzetë pikë katër) lekë.**

ZËVENDËSMINISTRI
I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Artan Shkreli



Lista paraprake e pronarëve të pasurive, pronë private, që shpronësohen nga realizimi i projektit
Ndërtimi i segmentit rrugor "Papër - Cërrik.

Nr	Emër Mbiemër	Lloji i Pasurisë	Z. K	Nr. i Pasurisë	Sip. Totale m2	Sip. E shpronësuar m2	Çmimi lekë/m2	Vlera totale në lekë	Shënime Sqaruese
1	Qemal Mehmet Musai	Tokë arë	3702	40/2	4050	629	222	139638	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Bashkim Mehmet Musai	Tokë arë	3702	40/3	3050	416	222	92352	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Asllan Mehmet Musai	Tokë arë	3702	40/4	1660	272	222	60384	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Dervish Hajdar Asllani	Tokë arë	3702	40/7	4250	403	222	89466	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Dervish Hajdar Asllani	Tokë arë	3702	40/8	1339	181	222	40182	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Fadil Dervish Qosja	Tokë arë	3702	40/9	2300	336	222	74592	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Halim Beqir Qosja	Tokë arë	3702	40/10	4600	712	222	158064	Konfirmuar nga ZVRPP
8	Bashkim Mehmet Musaj	Tokë arë	3702	40/15	14840	738	222	163836	Konfirmuar nga ZVRPP
9	Mehmet Pasho Cenja	Tokë arë	3702	40/16	1000	303	222	67266	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Bashkim dhe Dylfiqare Musai	Tokë arë	3702	40/20	4400	422	222	93684	Konfirmuar nga ZVRPP
11	Shtet	Tokë arë	3702	40/22	1495	126	0	0	Konfirmuar nga ZVRPP
12	Shtet	Tokë arë	3702	40/23	1000	123	0	0	Konfirmuar nga ZVRPP
13	Shtet	Tokë arë	3702	40/24	1595	107	0	0	Konfirmuar nga ZVRPP
14	Shtet	Tokë arë	3702	40/25	1125	76	0	0	Konfirmuar nga ZVRPP
15	Mustafa Hasan Rapi	Tokë arë	3702	41/2	1650	515	222	114330	Konfirmuar nga ZVRPP
16	Bashkim Mustafa Vrap	Tokë arë	3702	41/3	300	214	222	47508	Konfirmuar nga ZVRPP
17	Ferit Rapush Bullari	Tokë arë	3702	41/4	1600	167	222	37074	Konfirmuar nga ZVRPP
18	Gazmend Alush Hida	Tokë arë	3702	41/5	3000	297	222	65934	Konfirmuar nga ZVRPP
19	BP Hida	Tokë arë	3702	41/6	3250	478	222	106116	Konfirmuar nga ZVRPP
20	Zenel Xhafer Raga	Tokë arë	3702	41/8	5800	860	222	190920	Konfirmuar nga ZVRPP
21	Novruz Xhafer Raga	Tokë arë	3702	41/9	4000	15	222	3330	Konfirmuar nga ZVRPP
22	Novruz Xhafer Raga	Tokë arë	3702	41/10	1800	40	222	8880	Konfirmuar nga ZVRPP
23	Sulejman Pasho Cenja	Tokë arë	3702	37/5/1	3800	360.2	222	79964.4	Në proces konfirmimi
Vlera totale paraprake						7790.2		1633520.4	

shënim: 1. Vlerësimi i pasurisë së llojit "tokë arë", është kryer bazuar në VKM-në nr. 89, datë 03.02.2016.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë